



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.58

13 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.264, datë 2.2.2011	Për miratimin e formës dhe paraqitjes së gradave të Policisë së Burgjeve	2411
Vendim i KM nr.281, datë 6.4.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.79, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e stemës, të uniformës, gradave, emblemës, flamurit dhe shenjave të Policisë së Shtetit”	2413
Vendim i GJK nr.14, datë 3.5.2011	Me objekt shfuqizimin e vendimeve: nr.107, datë 23.5.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit; nr.117, datë 3.3.2009 të Gjykatës së Apelit të Vlorës; nr.760, datë 24.6.2010 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën	2414
Vendim i GJK nr.15, datë 3.5.2011	Me objekt shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.541, datë 7.7.2010 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kolsh”	2420
Vendim i GJK nr.16, datë 4.5.2011	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.313, datë 10.7.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.....	2424

VENDIM
Nr.264, datë 2.2.2011

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PARAQITJES SË GRADAVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28 të ligjit nr.10 032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Miratimin e formës dhe ndërtimit të gradave për Policinë e Burgjeve sipas përcaktimeve të bëra në albumin, që i bashkëlidhet dhe është pjesë e këtij vendimi.
2. Miratimin e gradave të Policisë së Burgjeve sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) Gradat e rolit bazë;
 - b) Gradat e rolit të mesëm;
 - c) Gradat e rolit të lartë.
3. Elementet përbërëse të gradave dhe shenjat dalluese/identifikuese të jenë sipas përshkrimeve në albumin që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ALBUM I GRADAVE TË POLICISË SË BURGJEVE



Grada “N/inspektor”

Është gradë fillestare e nivelit të rolit bazë. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të një shirit të verdhë (ngjyrë ari). Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.



Grada “Komisar”

Është gradë e dytë e nivelit të rolit të mesëm. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të një shirit të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë dhe një kurorë dafine dhe dy yje të mëdhenj me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari). Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.




Grada "Inspektor"

Është gradë e dytë e nivelit të rolit bazë. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të dy shiritat të verdhë (ngjyrë ari) me përmasa të ndryshme. Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.



Grada "K/komisar"

Është gradë e tretë e nivelit të rolit të mesëm. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të një shirit të verdhë (ngjyrë ari), me përmasë të gjerë dhe një kurorë dafine dhe tre yje të mëdhenj me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari). Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.



Grada "K/inspektor"

Është gradë e tretë e nivelit të rolit bazë. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të tre shiritat të verdhë (ngjyrë ari), një me përmasë të gjerë dhe dy me përmasa më të vogla, por të barabarta. Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.




Grada "Drejtues"

Është gradë e parë e nivelit të rolit të lartë. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të një shirit të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë, një kurorë dafine, një beden kalaje dhe një yll i madh me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari). Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.



Grada "N/Komisar"

Është gradë e parë e nivelit të rolit të mesëm. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të një shirit të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë dhe një kurorë dafine dhe një yll të madh me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari). Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.



Grada "Drejtues i parë"

Është gradë e dytë e nivelit të rolit të lartë. Paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, vendosur në të një shirit të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë, një kurorë dafine, një beden kalaje dhe dy yje të mëdhenj me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari). Në pjesën e trekëndëshit të spaletës së gradës është vendosur një kopsë me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari), në të cilën është gdhendur shqiponja e flamurit kombëtar.

VENDIM
Nr.281, datë 6.4.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.79, DATË 21.1.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STEMËS, TË UNIFORMËS,
GRADAVE, EMBLEMËS, FLAMURIT DHE SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 38 e 69 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.79, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2.3, “Uniformat”, shtohet pika 2.3.1, me këtë përmbajtje:

“2.3.1. Uniforma e policisë të jetë me ngjyrë blu të errët, me sistemin RGB, kodin 25-25-112, HEX # 191970.”.

2. Pika 2.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.4. Emblema: Përbëhet nga shqiponja dykrenare me ngjyrë të zezë, mbi të cilën është vendosur një mburojë me ngjyrë blu, e rrethuar nga të dyja anët me gjethe dushku, dhe përkrenarja e Skënderbeut me ngjyrë të artë, të stilizuara e të vendosura në një fushë me ngjyrë të kuqe. Në pjesën e poshtme, mbi një shirit ngjyrë blu, është shkruar me shkronja të mëdha fjala “POLICIA”.”.

3. Pika 2.5.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.5.3. Gradat për punonjës policie, të nivelit të mesëm drejtues: Gradat e nivelit të mesëm drejtues të jenë me fushë në ngjyrë blu të errët, mbi të cilën janë vendosur shqiponja e rrethuar nga degë dushku me ngjyrë të artë, dhe yje me ngjyrë të artë, me konturim me shirit në ngjyrë të artë, ku ndryshimi do të përcaktohet nga numri i yjeve, sipas gradave brenda nivelit, ku grada “Drejtues” ka një yll dhe grada “Drejtues i parë” ka dy yje.”.

4. Pika 2.5.4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2.5.4. Gradat për punonjës policie, të nivelit të lartë drejtues: Gradat për nivelin e lartë drejtues të jenë me fushë në ngjyrë të argjendtë, mbi të cilën janë vendosur shqiponja, e rrethuar nga degë dushku me ngjyrë të artë, dhe yje me ngjyrë të artë, me konturim me shirit në ngjyrë të artë, ku ndryshimi do të përcaktohet nga numri i yjeve, sipas gradave, brenda nivelit, ku grada “Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm” ka një yll dhe grada “Drejtor i Përgjithshëm” ka dy yje.”.

5. Pika 2.6.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.6.2. Numri personal i punonjësit të policisë përmban logon e policisë, numrin e identifikimit, me pesë karaktere, të shkruar me ngjyrë të bardhë në një sfond blu të errët, me konturim me shirit në ngjyrë të kuqe.”.

6. Në albumin bashkëlidhur vendimit, modeli i emblemës së Policisë së Shtetit ndryshohet sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

EMBLEMA E POLICISË SË SHTETIT



VENDIM Nr.14, datë 3.5.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pllloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 10.2.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 45/30 Akti, që i përket:

KËRKUES: Luan Marra, përfaqësuar nga avokat Dilaver Bengasi dhe avokat Alban Bengasi, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve: nr.107, datë 23.5.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit; nr.117, datë 3.3.2009 të Gjykatës së Apelit të Vlorës; nr.760, datë 24.6.2010 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo; kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Shtetasi Luan Marra është dënuar me vendimin nr.107, datë 23.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit për kryerjen e veprës penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake, të parashikuara nga nenet 79/a-b-dh/ dhe 278/2 të Kodit Penal (KP).

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Vlorës me vendimin nr. 117, datë 3.3.2009.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr.760, datë 24.6.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

Në datën 21.9.2010 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të lartpërmendura, duke pretenduar se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Kërkuesi pretendon se i janë cenuar të drejtat që burojnë nga nenet e mëposhtme të Kushtetutës:

- Neni 25, për arsye se ndaj tij është ushtruar dhunë në mjediset e komisarariatit të policisë së Beratit.

- Neni 27, për arsye se Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Beratit ka vendosur paraburgimin e të dënuarit në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

- Neni 30 i Kushtetutës, për arsye se nga gjykatat është paragjykuar përgjegjësia penale e të pandehurit.

- Neni 31, për arsye se gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit nuk ka qenë i pranishëm mbrojtësi i tij ligjor.

- Neni 32, për arsye se nëpërmjet dhunës dhe pa pjesëmarrjen e mbrojtësit ligjor, është përfutur nga i pandehuri një deklaratë, në të cilën ky i fundit pranonte përgjegjësinë penale për veprat e cituara në objektin e kërkesës.

- Neni 142/1, pasi vendimet e sipërpërmendura të gjykatave nuk janë të arsyetuara dhe as të mbështetur në prova.

Për sa më sipër, sipas kërkuesit, shkelja e neneve të sipërcituara të Kushtetutës sjell si pasojë cenimin e nenit 42 të saj, që garanton të drejtën e shtetasve për një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, për të njëjtat arsye si më sipër, kërkuesi argumenton se cenohen dhe nenet 3, 5, 6, 14, 17 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

II

Për pretendimin për cenim të të drejtës së mbrojtjes

Kërkuesi pretendon se është marrë në pyetje pa praninë e mbrojtësit.

Në jurisprudencën e saj konstante Gjykata Kushtetuese (Gjykata), duke u bazuar edhe në vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka vërejtur se mënyra se si merren provat është prerogativë e juridiksionit kushtetues. Posaçërisht Gjykata është shprehur se, në nenin 32, pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë parashikohet se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës së Strasburgut si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës.

Në bazë të KEDNJ-së, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse ishte e drejtë procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat.

Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt.¹ Asnjë gjykatë nuk ka mundësi që, pa dëmtuar dhënien e “përmasës së duhur të drejtësisë”, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme.

Nisur nga këto qëndrime të evidentuara në jurisprudencën europiane, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qëndrimin e saj, duke evidentuar dallimin që ekziston në një proces ligjor ndërmjet mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre. “Vlerësimi i provave mbetet një çështje për t’u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet, kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit” (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 27.4.2005*).

Nga vendimet objekt kundërshtimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit dhe Gjykatës së Apelit të Vlorës rezulton se është provuar në rrugë gjyqësore se i pandehuri Luan Marra është marrë në pyetje në mjediset policore pa praninë e mbrojtësit ligjor dhe se ky i fundit, i thirrur pas përfundimit të pyetjes, më pas ka nënshkruar një deklaratë, sipas së cilës i pandehuri kishte pranuar para punonjësve të policisë autorësinë për veprën e kryer. Gjatë gjykimit në shkallën e parë, i pandehuri ka pretenduar se është detyruar të nënshkruante deklarin, në të cilin pranonte fajin, si pasojë e dhunës së vazhdueshme, të ushtruar ndaj tij nga punonjës policie.

Prokuroria ka paraqitur para gjykatës si prova në ngarkim të të pandehurit, procesverbalin e pyetjes së tij dhe një eksperiment hetimor, nga të cilat, sipas prokurorisë, provohet fajësia e të akuzuarit.

Duke iu referuar Kodit të Procedurës Penale (KPP), dispozitat që rregullojnë marrjen në pyetje të të pandehurit janë nenet 37, 38 dhe 39 të këtij Kodi. Të tri këto nene mund të analizohen vetëm në harmoni me njëri-tjetrin dhe në funksion të respektimit të garancive kushtetuese që burojnë nga nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës.

Posaçërisht, në nenin 37 të KPP-së parashikohet se në momentin që personi, i cili akoma nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit, bën deklarime, prej të cilave mund të burojnë përgjegjësi penale, organi procedues ndërpret marrjen në pyetje dhe e fton personin që të caktojë një mbrojtës.

Prania e mbrojtësit është një kusht i domosdoshëm për vazhdimin e marrjes në pyetje të personit, pasi ndryshe nuk mund të shpjgohet detyrimi për punonjës të policisë që të ndërpresë marrjen në pyetje. Kjo e bën mbrojtësin ligjor një subjekt të domosdoshëm dhe të pazëvendësueshëm gjatë kryerjes së këtij veprimi procedural dhe për rrjedhojë, mungesa e tij çon në cenim të nenit 31 të Kushtetutës.

Fakti që neni 37 i KPP-së parashikon ftesën që i bëhet personit që po merret në pyetje që të zgjedhë një mbrojtës, nuk mund të lexohet në mënyrën që e ka interpretuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Beratit, sipas së cilës është e mjaftueshme që mbrojtësi të verifikojë në një moment të mëvonshëm nëse deklaratat e personit të ndaluar janë bërë me vullnetin e tij të lirë. Përkundrazi, Gjykata çmon se mbrojtësi ligjor duhet të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarit, dhe mbi të gjitha, duhet që në çdo rast të kujdeset për interesat e të ndaluarit. Ky konkluzion është jo vetëm një interpretim logjik i normave të sipërpërmendura, por, gjithashtu, është një standard kushtetues, i pranuar përgjithësisht jo vetëm në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, por edhe të GJEDNJ-së.

Ndërsa ndalimi i parashikuar nga neni 38/2 i KPP-së që ndaj personit të marrë në pyetje nuk mund të përdoren metoda ose teknika për të ndikuar mbi vullnetin e lirë të tij mund të lexohet nga Gjykata vetëm në kuptimin më të gjerë të mundshëm duke ndaluar çdo lloj sjelljeje, nga ana e organeve të zbatimit të ligjit që mund të lërë shteg për dyshime se vullneti i personit të marrë në pyetje është dhunuar. Dhe në këtë kuptim, pjesëmarrja e mbrojtësit është një garanci serioze jo

1 (Shiko: vendimi në çështjen e “Vindishit kundër Austrisë” i 27 shtatorit të vitit 1990; A.186.

Vendimi “Schenk kundër Zvicrës”, i datës 12.7.1988, A.140, par.46.).

vetëm për mbrojtjen e interesave të të ndaluarit ose të pandehurit, por edhe për të garantuar një proces të rregullt ligjor në funksion të dhënies të drejtësisë.

Gjykata, për sa më sipër, vlerëson se ndaj kërkuesit është cenuar standardi kushtetues i parashikuar nga neni 31 i Kushtetutës.

III

Për pretendimin për cenimin e nenit 25 dhe 32 të Kushtetutës

Kërkuesi pretendon se provat në ngarkim të tij janë marrë nëpërmjet dhunës. Sipas tij, pranimi i autorësisë të krimit në dhomat e paraburgimit ka ardhur si pasojë e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë.

Neni 25 i Kushtetutës ndalon çdo lloj forme torture ose trajtimi çnjerëzor, kurse neni 32 i Kushtetutës parashikon dy ndalime: Së pari, që askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes dhe as ta pohojë fajësinë dhe, së dyti që askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Gjykata konstaton se sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, të kryer me kërkesën e prokurorit, tek i ndaluarit Luan Marra janë vërejtur ekimoza në nofull dhe në shputat e këmbëve. Megjithatë organi procedues, menjëherë sa është vënë në kontakt me të ndaluarin, e ka vlerësuar pretendimin për përdorimin e dhunës ndaj tij dhe ka urdhëruar ekzaminimin mjeko-ligjor, nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejshme hetimore, për të sqaruar prejardhjen e dëmtimeve të vërejtura, si dhe rrethanat e tjera në të cilat i ndaluarit është marrë në pyetje nga punonjësit e policisë.

Gjykata vëren se ndonëse të ndodhura para pretendimeve dhe dyshimeve serioze faktike për ligjshmërinë e marrjes në pyetje të kërkuesit në dhomat e paraburgimit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm për të kërkuar dhe sqaruar deri në fund të gjitha rrethanat e çështjes, për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim vërehen dyshime serioze për kushtet dhe rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij për veprën për të cilën akuzohet, për rrjedhojë edhe në përmbushjen e standardeve për një proces të rregullt ligjor lidhur me mënyrën e marrjes së provave. Në rastin konkret jo vetëm që ka dyshime serioze se ndaj kërkuesit është ushtruar dhunë për të marrë pohimin e tij, por pretendohet nga ky i fundit se është detyruar të dëshmojë kundër vetvetes, në kundërshtim me ndalimet që burojnë nga nenet 25 dhe 32 të Kushtetutës.

Gjykata çmon se është e papranueshme që në një shtet të së drejtës e gjithë akuza të mbështetet kryesisht në deklaratimet e një personi, i cili jo vetëm është marrë në pyetje pa praninë e avokatit, por dhe që pretendon se këto deklarime janë bërë për shkak të dhunës të ushtruar ndaj tij. Për më tepër Konventa kundër torturës dhe akteve çnjerëzore dhe degraduese, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1994, detyron vendet anëtare që për çdo rast, ku ka pretendime se është ushtruar torturë nga ana e funksionarëve publikë, lind nevoja e një hetimi të pavarur dhe të gjithanshëm.

Posaçërisht nenet 11, 12, 13 të kësaj Konvente përcaktojnë se:

“Çdo shtet palë ushtron një mbikëqyrje sistematike të rregullave, udhëzimeve, metodave dhe praktikave të pyetjes dhe të dispozitave lidhur me ruajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar, të privuar nga liria, ose të burgosur në çfarëdo mënyre, në çdo pikë nën juridiksionin e tij, në mënyrë që të mënjanohet çdo rast i torturës.

Çdo shtet palë siguron që autoritetet kompetente të fillojnë menjëherë një hetim të paanshëm kurdoherë që ka motive të arsyeshme për të besuar se një veprim i torturës është ushtruar në çdo pikë të territorit të tij.

Çdo shtet palë i siguron çdo personi, që pretendon se i është nënshtuar torturës nën cilindo territor nën juridiksionin e tij, të drejtën e ankimit pranë autoriteteve kompetente të shtetit në fjalë, të cilat do ta shqyrtojnë çështjen menjëherë dhe me paanësi. Do të merren masa për të siguruar mbrojtjen e ankuesit dhe të dëshmitarëve kundër keqtrajtitimit, ose frikësimit si pasojë e ankimit, ose dhënies së një dëshmie.”

Gjykata çmon se në çështjen objekt shqyrtimi si nga Prokuroria, ashtu dhe nga gjykatat nuk janë përmbushur, gjithashtu, detyrimet që burojnë nga Konventa në fjalë për një hetim të plotë dhe të pavarur të të gjitha pretendimeve të kërkuarit për ushtrim dhune ndaj tij.

Republika e Shqipërisë, veç Kushtetutës, ka tashmë një legjislacion të plotë për të garantuar jo vetëm zbatimin e saj, por edhe të detyrimeve që burojnë nga dokumentet ndërkombëtare, në të cilat është palë. Në këtë kuadër, ligji nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, si dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve japin detaje të hollësishme për masat që duhet të marrë institucioni në mënyrë që personi i burgosur ose i paraburgosur, që ndodhet në “ruajtje” (*custody-custodia*) pranë tyre, të mos dëmtojë veten ose të tretët, duke zbatuar një parim universal për trajtimin e personave të cilëve u hiqet liria. Në këto kushte, nëse personi që pretendon se është dhunuar, ka dëmtuar veten, është detyrë e organeve që e mbajnë në gjendje “ruajtjeje” të japin sqarime në lidhje me rrethanat e dëmtimit të tij. Sipas Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në çështjet e gjykuara prej saj për cenim të nenit 5 të KEDNJ-së, janë pikërisht detajet në lidhje me rrethanat se si ka ndodhur dëmtimi i personit, hetimi i të cilave hedh dritë për përdorimin ose jo të forcës nga ana e organeve të zbatimit të ligjit.

Standardi kushtetues në lidhje me procesin e rregullt ligjor gjatë hetimit penal kërkon që organi procedues të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i atribuohet. Çdo i pandehur ka absolutisht të drejtë që të mos japë asnjë lloj kontributi gjatë hetimit gjyqësor ose gjatë procesit dhe kjo është një e drejtë e pamohueshme.

Funksioni i procesit penal, si u tha më sipër, është hetimi dhe zbulimi i plotë i ngjarjeve që përbëjnë vepra penale dhe si i tillë është në shërbim të së drejtës penale materiale. Në këtë kuptim, që të ketë një dënim penal, duhet patjetër që të zbardhen të gjitha elementet e veprës penale.

Për këtë argument Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka konsoliduar qëndrimin se deklaratimet e bëra para prokurorit ose policisë gjyqësore nuk përbëjnë prova në vetvete. Në rastin e kundërshtimit të këtyre thënieve në gjykatë, në kuptim të nenit 362 të KPP-së, ato nuk janë provë, por vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur. Deklarimet e dhëna para organeve të lartpërmendura mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, krahas pohimit që i ka bërë veprës kërkuar para punonjësve të policisë në dhomat e paraburgimit, kanë konsideruar të besueshëm një eksperiment hetimor ku, sipas tyre, ai ka treguar se si ka ndodhur ngjarja.

Gjykata çmon se ky eksperiment i kryer nga organet e policisë, menjëherë pasi kërkuar ka inkriminuar veten dhe në rrethanat e përshkruara më lart, për më tepër pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit, jo vetëm krijon dyshime serioze për ligjshmërinë e tij, por vjen në kundërshtim edhe me standardin kushtetues të pranuar përgjithësisht për mënyrën e marrjes dhe të vlerësimit të provave.

IV

Për pretendimin për cenimin e nenit 142/1 të Kushtetutës

Kërkuar ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë cenuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve, pasi nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të të pandehurit për ushtrimin e dhunës ndaj tij. Deklarimet e dhëna gjatë marrjes në pyetje dhe gjatë eksperimentit hetimor, të cilat pretendohet se janë përfutur nëpërmjet përdorimit të dhunës, nuk përputhen me provat shkencore dhe deklaratimet e dëshmitarëve në proces.

Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se organet gjyqësore, në kryerjen e funksioneve të nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsytuara. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur në mënyrë të përsëritur se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsytuara në mënyrë të mjaftueshme. KPP-ja për vendimin penal parashikon se vendimi arsyetohet, ndryshe është i pavlefshëm. Neni 383 i KPP-së kërkon elementet që duhet të përmbajë një vendim, ku ndër të tjera parashikon një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, arsyet për të cilat

gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 2.4.2008*). Domosdoshmëria e arsytimit të vendimeve gjyqësore është një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre.

Në vështrim të standardit të mësipërm kushtetues dhe rrethanave të çështjes, Gjykata çmon se vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit dhe të Gjykatës të Apelit të Vlorës, e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre dhe, në këtë kuptim, kërkesa për këtë pjesë të saj duhet rrëzuar si e pabazuar.

Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “a” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.760, datë 24.6.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

- Shfuqizimin e vendimit nr.117, datë 3.3.2009 të Gjykatës së Apelit të Vlorës.

- Shfuqizimin e vendimit nr.107, datë 23.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Beratit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

VENDIM
Nr.15, datë 3.5.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 9.12.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.29/4 Akti që i përket:

KËRKUES: Abedin Oruci

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, Abaz Deda me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.541, datë 7.7.2010 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kolsh”.

BAZA LIGJORE: Neni 115 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 42 i ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Këshillin e Ministrave, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi ka ushtruar detyrën e kryetarit të komunës Kolsh. Me vendimin nr.541, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, kërkuesi është shkarkuar nga detyra me motivin për shkelje të rënda të ligjit. Vendimi i Këshillit të Ministrave bazohet në relacionin e Ministrit të Brendshëm, i cili i referohej raportit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, lidhur me shkeljet e kryera nga kërkuesi. Konkretisht, kërkuesi nuk kishte deklaruar të ardhura të bëra për shkak të shpronësimit me qëllim ndërtimin e rrugës mbi pronën e tij, ndërtimin e tri objekteve, të cilat rezultojnë në emër të tij në kërkesën e bërë për legalizimin e tyre, si: stacioni i karburantit, depo nëntokësore dhe një magazinë ekzistuese të regjistruara në ZVRPP Kukës në emër të kërkuesit.

Për problemet e konstatuara në deklaratat e interesave privatë, subjekti është thirrur disa herë për t’u pyetur në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive (ILDKP), por edhe pas njoftimeve shkresore dhe kontakteve me telefon ka refuzuar të paraqitet për të dhënë shpjegimet e tij mbi parregullsitë e evidentuara gjatë kontrollit të ushtruar mbi deklaratat e tij të interesave privatë.

Për këtë arsye, ILDKP-ja, bazuar në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 257/a/2 të Kodit Penal, ka kërkuar fillimin e procedimit penal ndaj kërkuesit për veprën penale të refuzimit për deklaram, të mosdeklarimit, të fshehjes ose të deklaramit të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr.55, datë 16.6.2010, ka vendosur deklaramin fajtor të të pandehurit Abedin Oruçi për kryerjen e veprës penale të deklaramit të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 33 660 lekë gjobë. Gjykimi i tij është bërë duke iu referuar nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale mbi gjykimin e shkurtuar. Vendimi i mësipërm është ankimuar nga kërkuesi dhe është duke u gjykuar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Gjithashtu, ILDKP-ja, në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i është drejtuar Këshillit të Ministrave, si organi kompetent për marrjen e masës së shkarkimit ndaj kryetarit të komunës, duke i kërkuar që të marrë masat ligjore përkatëse ndaj kërkuesit. Mbi bazën e këtij materiali, Ministri i Brendshëm i ka propozuar Këshillit të Ministrave shkarkimin nga detyra të kërkuesit.

1. *Kërkuesi* pretendon se vendimi nr.541, datë 7.7.2010 i Këshillit të Ministrave është antikushtetues, pasi nuk përmban asnjë shkelle konkrete të ligjit ose të Kushtetutës, ku bazohet shkarkimi i tij. Ai ende sot nuk është në dijeni të motivit ku mbështetet shkarkimi i tij. Për këtë arsye, ai kërkon shfuqizimin e këtij vendimi si të pambështetur në nenin 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe në nenin 115 të Kushtetutës.

2. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, parashtrroi se:

2.1 Kërkuesi e ka ushtruar ankimin jashtë afatit ligjor prej 15 ditësh, pasi vendimi është marrë nga Këshilli i Ministrave me datë 7.7.2010, kurse kërkesa para Gjykatës Kushtetuese është paraqitur me datë 24.8.2010, pra jashtë afatit që parashikon neni 115 i Kushtetutës prej 15 ditësh.

2.2 Shkaqet e shkarkimit të kërkuesit nga detyra janë të paraqitura në relacionin e përgatitur nga Ministri i Brendshëm, i cili i ka propozuar Këshillit të Ministrave shkarkimin e kryetarit të komunës, bazuar në nenin 42/a të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i cili parashikon shkellen e rëndë të ligjit ose të Kushtetutës si shkak për shkarkimin organeve të qeverisjes vendore. Shkeljet e ligjit jo gjithmonë duhet të jenë të lidhura me përgjegjësinë penale, e cila në vetvete përbën një shkak tjetër të shkarkimit të kryetarit të komunës ose të bashkisë. Si rrjedhojë, kërkuesi është shkarkuar nga detyra sepse ka shkelur nenin 3 dhe 4 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, duke mos deklaruar pasuri të regjistruara në emër të tij. Gjithashtu, ai ka shkelur edhe nenet 3, 10 dhe 44 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, duke kryer veprime që vijnë në kundërshtim me përbushjen e rregullt të detyrave të tij si i zgjedhur vendor.

II

1. *Lidhur me çështjen e legjitimitetit për shkak të tejkalimit të afatit të ankimit (ratione temporis)*

Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, pretendon se kërkuesi e ka ushtruar ankimin jashtë afatit ligjor prej 15 ditësh, pasi vendimi është marrë nga Këshilli i Ministrave me datë 7.7.2010, kurse kërkesa para Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) është paraqitur me datë 24.8.2010, pra jashtë afatit që parashikon neni 115 i Kushtetutës.

Gjykata çmon se, ndryshe nga pretendimi i subjektit të interesuar, kërkuesi e ka ushtruar ankimin brenda afatit kushtetues.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga palët në gjykim, rezulton se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.541, datë 7.7.2010 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kolsh, Abedin Oruçit” është dërguar për botim në Qendrën e Publikimeve Zyrtare dhe për njoftim

organeve përkatëse me datë 15.7.2010. Me shkresën nr.554/1 Prot., datë 10.8.2010 ka mbërritur në sekretarinë e komunës Kolsh vendimi nr.541, datë 7.7.2010 i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra. Me vendimin nr.55, datë 23.8.2010 të këshillit të komunës Kolsh është vendosur kërkimi i arsyeve për shkarkimin e kryetarit të komunës (kërkuesit). Kërkuesi e ka paraqitur kërkesën para Gjykatës me datë 24.8.2010.

Gjykata është shprehur në jurisprudencë të vazhdueshme se si datë e fillimit të afateve të ankimit ndaj aktit individual që cenon të drejtat e personit objekt i këtij akti do të konsiderohet data e marrjes dijeni nga personi për ekzistencën e aktit, pavarësisht formave të tjera të publikimit (vendimet nr.30/2006; nr.39/2005; nr.22/2008; nr.15/2009 të Gjykatës Kushtetuese). Për këtë arsye, si datë e marrjes dijeni do të llogaritet data e mbërritjes së vendimit të shkarkimit pranë këshillit të komunës Kolsh, pra 10.8.2010. Duke iu referuar kësaj date, rezulton se kërkuesi ka respektuar afatin 15-ditor të ankimit para kësaj Gjykate dhe për këtë arsye kërkesa e tij është pranuar për gjykim.

2. Lidhur me pretendimin për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës në mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 115/1 të Kushtetutës

Kërkuesi pretendon se ai nuk është vënë asnjëherë në dijeni të shkaqeve të shkarkimit nga detyra nga Këshilli i Ministrave, si dhe mohon të ketë kryer sjellje dhe akte që bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjin.

Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

Shkelja që i atribuohet kërkuesit, mbi të cilën është bazuar vendimi objekt shqyrtimi për shkarkimin nga detyra të kërkuesit, lidhet me deklaratimet e rreme dhe fshehjen e deklaratimeve si detyrim që rrjedh nga ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Nga relacioni i përgatitur prej Ministrit të Brendshëm, del se deklaratimet dhe të dhënat e mbledhura nga ILDKP për kërkuesin kanë rezultuar të pasakta. Kështu ILDKP, pas verifikimeve të bëra, ka konkluduar se kërkuesi nuk ka deklaruar pasuri, të tilla si: objektin pikë karburanti, i regjistruar në ZRPP Kukës; troje me sipërfaqe prej 3614 m² të regjistruara në ZRPP Kukës; tri objekte banimi në proces legalizimi. Me gjithë njoftimet drejtuar kërkuesit për sqarimin lidhur me to, ai ka refuzuar paraqitjen dhe dhënien e shpjegimeve para ILDKP-së. E ndodhur në këto kushte, ILDKP-ja ka vënë në dijeni dhe i ka kërkuar Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse ligjore ndaj këtij subjekti. Pas verifikimeve dhe kontrolleve të kryera nga organet kompetente, kjo sjellje e kërkuesit, duke qenë se bie ndesh me detyrimet ligjore, është konsideruar si shkak i mjaftueshëm nga ana e Ministrit të Brendshëm, për t’i propozuar Këshillit të Ministrave shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të komunës.

Gjithashtu, në të njëjtën kohë, ILDKP-ja ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës për fillimin e ndjekjes penale të kërkuesit lidhur me veprën penale të deklarimit të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr.55, datë 16.6.2010 ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit Abedin Oruçi dhe dënimin e tij me 33 660 lekë gjobë.

Gjykata ka theksuar në praktikën e saj se, si rregull, përgjegjësia penale konkurron me përgjegjësinë administrative ose disiplinore. Prandaj, pavarësisht nga procedimi penal, Këshilli i Ministrave, si organ administrativ, mund të nisë njëherazi një procedurë administrative për shkelje, për të cilat konstatohet përgjegjësi administrative (vendimi nr.22/2008 i Gjykatës Kushtetuese). Gjithashtu, Gjykata, në jurisprudencë të vazhdueshme, ka mbajtur qëndrimin se kuptimi i saktë dhe i drejtë i konceptit “shkelje e rëndë e ligjit”, të parashikuar në nenin 115 të Kushtetutës, vlerësohet në tërësinë e saj nga disa faktorë që lidhen me rëndësinë e ligjit të shkelur, kohëvazhdimin e këtyre pasojave, si dhe qëndrimin subjektiv të autorit ndaj shkeljes së kryer (vendimet nr.22/2008, nr.25/2000, nr.50/2000 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata vlerëson se deklarimi i rremë i pasurive dhe interesave financiarë ose mosdeklarimi (fshehja) i tyre, sipas ligjit përkatës, konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit. Është vërtetuar në rrugë administrative (nga ILDKP) dhe në rrugë gjyqësore (nga gjykata e rrethit gjyqësor Kukës, e cila e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me gjobë) se kërkuesi ka kryer veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin.

Gjykata çmon se kërkuesi me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shkelur disa ligje. Kështu, kërkuesi ka vepruar në kundërshtim jo vetëm me ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, por edhe në kundërshtim me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Përsa i takon ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, kërkuesi ka vepruar në kundërshtim me të, duke qenë se pasuria e deklaruar dhe e fshehur marrë në total, sipas investigimeve të kryera nga ILDKP-ja, nuk justifikohet me të ardhurat e fituara nga detyra e tij si kryetar komune ose burime të tjera të ligjshme. Ndërsa lidhur me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, rezulton se kërkuesi, duke ushtruar detyrën e kryetarit të komunës, ka bërë ndërtime të paligjshme në emër të tij në territorin e komunës.

Meqë si pjesë e kontrollit kushtetues të aktit të shkarkimit nga detyra të kërkuesit, kjo Gjykatë shqyrton edhe qëndrimin subjektiv të kërkuesit ndaj shkeljes së atribuar, është me interes të analizohet edhe argumenti i paraqitur nga kërkuesi në seancën e zhvilluar për këtë qëllim. Argumenti kryesor që përdori kërkuesi, për të kundërshtuar vendimin e shkarkimit, ishte padijenja për detyrimin për deklarimin e pasurive për legalizim ose atyre që, sipas tij, u takojnë vëllezërve të tij. Megjithatë ai, gjithashtu, pranoi para Gjykatës se objektet në proces legalizimi, ai me dijeni dhe vullnet të plotë, i kishte regjistruar në emër të tij dhe jo të vëllezërve, pasi, sipas tij, kjo ishte bërë vetëm për të shpejtuar dhe lehtësuar procedurat e legalizimit në emër të një personi. Ky deklarim vërteton se kërkuesi i ka kryer veprimet juridike të mësipërme në dijeni të plotë të pasojave që ato mbartin me vete. Edhe sikur të pranohet *a priori* argumenti i kërkuesit për mungesën e dijenisë, e cila në vetvete nuk përbën shkak për përjashtimin nga përgjegjësia të kërkuesit, provohet në rrugë shkresore se ILDKP-ja i ka tërhequr vëmendjen dhe i ka kërkuar disa herë kërkuesit të paraqitej për verifikim të mëtejshëm, duke i sjellë në kujtesë dhe pasojat ligjore në rast të mosbindjes, gjë që është refuzuar në mënyrë të përsëritur nga kërkuesi.

Gjithashtu, nga materialet e paraqitura nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, si dhe të konfirmuara nga vetë kërkuesi në seancë, rezulton se kërkuesi ka kryer edhe ndërtime pa leje në interes të tij, gjatë kohës që ushtronte detyrën e kryetarit të komunës Kolsh. Nisur nga funksioni dhe detyrat e kryetarit të komunës, i cili, midis të tjerave, është organi përgjegjës për ruajtjen e sipërfaqeve publike dhe planifikimin e territorit sipas ligjit përkatës për urbanistikën, rezulton se ai nuk ka përmbushur siç duhet detyrën e tij në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, Gjykata krijon bindjen sa i takon qëndrimin subjektiv të kërkuesit. Ky i fundit, gjatë seancës gjyqësore, deklaroi se ndërtimet pa leje ishin bërë me ndërgjegje dhe se, në kuadër të situatës së përgjithshme të ndërtimeve pa leje në vend, veprimet e tij nuk duhej të konsideroheshin si shkelje të ligjit dhe si të tilla si shkaqe për shkarkim nga detyra.

Duke marrë në konsideratë edhe aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore, konkretisht nenin 4 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Gjykata vëren se një nga parimet themelore të funksionimit të njësisë të qeverisjes vendore është që në veprimtarinë e tyre ato duhet të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera të nxjerra në bazë të tyre. Shkeljet e kryera nga kërkuesi, në detyrën e kryetarit të komunës, janë të tilla që dëmtojnë rëndë imazhin e zyrtarit publik dhe janë të lidhura ngushtë me ushtrimin e rregullt të funksionit të tij.

Duke iu referuar këtyre sjelljeve të kërkuesit dhe organeve kompetente për zbatimin e ligjeve të sipërpërmendura, Gjykata krijon bindjen se kërkuesi ka vepruar në kundërshtim të kërkesave të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Si rrjedhojë, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.541, datë 7.7.2010 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kolsh” është i bazuar në kuptim të nenit 115 të Kushtetutës, dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115/2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Petrit Pllaçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.

VENDIM

Nr.16, datë 4.5.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese (kryesues i seancës)
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 27.1.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. Akti 35/20 që i përket:

KËRKUES: Artan Hajdini, përfaqësuar nga avokati, Luan Shabani, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

- Zyra e Përmbartimit, Tiranë, në mungesë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përfaqësuar nga Eriola Sovali, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.313, datë 10.7.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6 i Konvetës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesen e subjektit të interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Artan Hajdini ka punuar në administratën tatimore si inspektor në Zyrën e Informacionit dhe Investigimit në Degën e Tatimeve të Fierit, në periudhën gusht 2003–tetor 2006. Me aktin administrativ nr.1570, datë 25.10.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është larguar nga shërbimi civil. Marrëdhëniet financiare i janë ndërprerë në 30.10.2006.

2. Kërkuesi është ankuar, kundër vendimit të mësipërm, në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC). Ky i fundit, me vendimin nr.695, datë 21.12.2006, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm si inspektor kontrolli në degën e tatimeve Fier dhe detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të bërë pagesën e kërkuesit që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.313 datë 10.7.2007, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së ngritur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe lënien në fuqi të vendimit të KSHC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.438, më datë 16.4.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit.

Me vendimin nr.58, datë 23.4.2008, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 313, datë 10.7.2007 të Gjykatës së Apelit, Tiranë.

4. Zyra e Përmbartimit Tiranë në datë 16.6.2008, me shkresën nr.7774 i ka drejtuar DPT-së lajmërim për ekzekutim vullnetar; me shkresën nr.8694, datë 26.6.2008 “Vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm; me shkresën nr.18968, datë 10.12.2009 “Kërkesë e përsëritur për ekzekutim titulli ekzekutiv”; me shkresën nr.874, datë 18.1.2010 “Vendim për gjobitje të personit të ngarkuar nga ligji”; me shkresën nr.6992, datë 3.5.2010 “Kërkesë për ekzekutim të titujve ekzekutivë”.

5. Kërkuesi pretendon përpara Gjykatës Kushtetuese se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

II

Për pretendimin se kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*vendimet nr.27, datë 20.6.2007; dhe nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*vendimet nr.6, datë 31.03.2006; dhe nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata është shprehur edhe më parë se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (*vendimi nr.6, datë 6.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*vendimi nr.43, datë 19.12.2007 i Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjykata është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkuarit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, vëllimin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*vendimet nr.6, datë 31.3.2006; nr.43, datë 19.12.2007; nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Me qëllim analizimin e sjelljes së palëve në dritën e standardeve kushtetuese, në çështjen objekt shqyrtimi, merren në konsideratë edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC) për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto dispozita sqarojnë procedurat ligjore, të cilat duhen plotësuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

9. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vlerëson nëse Zyra e Përmbarrimit Tiranë i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe, në këtë mënyrë, vlerësohet nëse veprimet ose mosveprimet, të kryera nga autoritetet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e vendimit gjyqësor, janë në përputhje me standardin kushtetues të gjykimit të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

10. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se Zyra e Përmbarrimit Tiranë, në datën 16.6.2008 ka nxjerrë aktin “Lajmërim për ekzekutim vullnetar” të urdhrin të ekzekutimit Nr.58, datë 23.4.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë lajmërim përcaktohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e detyruar të kthejë kërkuarin, Artan Hajdini, në vendin e mëparshëm të punës dhe t’i bëjë atij pagesën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi, gjithsej në shumën 1 304 704 lekë. Për shkak të mosekzekutimit vullnetar, Zyra e Përmbarrimit ka vendosur për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Ky vendim shpreh edhe se këtij vendimi i bashkëngjitet vendosja e masës së sekuestros në llogaritë e debitorit në bankat e nivelit të dytë. Në vazhdim të veprimeve të mësipërme janë nxjerrë edhe këto akte: në datë 12.1.2010, “Kërkesë e përsëritur për ekzekutim titulli ekzekutiv”; në datë 18.1.2010, “Vendim për gjobitjen e personit të ngarkuar nga ligji, ku Artur Papajani, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, gjobitet me 50 000 lekë për pengim ekzekutimi të veprimeve përmbarrimore në zbatim të titullit ekzekutiv; në datë 20.1.2010, “Kërkesë për ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe dërgim informacioni për çështjet, me palë debitore Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në datë 13.5.2008, ka lëshuar vërtetim nga dega e tatimeve Fier se kërkuari Artan Hajdini, ka qenë punonjës i kësaj dege, është larguar në 30 tetor 2006 dhe se paga bruto në muajin tetor ka qenë 55 425 lekë. Ky vërtetim është lëshuar për Zyrën e Përmbarrimit. Në datën 7.7.2008, DPT-ja i kthen përgjigje Zyrës së Përmbarrimit, duke e informuar se pranë Gjykatës së Lartë është paraqitur kërkesa për pezullim të urdhrin të ekzekutimit dhe se ky urdhër do të ekzekutohet pasi kjo çështje të gjykohej nga Gjykata e Lartë. Në datën 3.2.2010 i dërgohet Zyrës së Përmbarrimit sqarimi se “për kreditorin Artan Hajdini duhet të dërgohen vendimet gjyqësore dhe vërtetimi i pagës. Pasi të bëhet plotësimi i dokumentacionit do të shqyrtohet vendimi gjyqësor”. DPT-ja, edhe përpara Gjykatës Kushtetuese, pretendon se Zyra e Përmbarrimit nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për të zbatuar urdhrin e ekzekutimit ndaj kreditorit, Artan Hajdini.

12. Gjykata vëren se urdhri ekzekutiv i lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë mban datën 23.4.2008. Pra, kanë kaluar rreth 2 vjet e 8 muaj nga data që ka dalë ky urdhër dhe ai ende nuk është zbatuar. Arsyet e parashtruara nga DPT-ja për moszbatimin e urdhrin të ekzekutimit janë të pambështetura. Kështu, argumentet për plotësim dokumentacioni me vendimin gjyqësor, kur vetë DPT-ja është shprehur në një shkresë se ka kërkuar pezullim në Gjykatë të Lartë të këtij urdhri ekzekutimi, qartëson faktin se kjo drejtori ka pasur dijeni për këtë akt. Vendimi nr.438, datë 16.4.2010 i Gjykatës së Lartë, me kërkuar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.695 datë 21.12.2006 të Komisionit të Shërbimit Civil, i cili është vendimi që lidhet me çështjen e kërkuarit Artan Hajdini, konfirmon edhe njëherë faktin se DPT-ja kishte dijeni për përmbajtjen e vendimeve që lidhen me kërkuarin dhe detyrimet e saj përkatëse. Edhe pretendimi i DPT-së se Zyra e Përmbarrimit duhet të plotësonte dokumentacionin me vërtetimin

e pagës së kërkuarit për kohën që ka qenë punonjës i DPT-së, dega e Fierit, është i pabazuar. Është vetë kjo drejtori (dega e Fierit) që ka lëshuar vërtetimin për Zyrën e Përmbartimit, ku përcaktohet edhe paga bruto për pozicionin që ka mbajtur kërkuari.

13. Gjykata vëren se Zyra e Përmbartimit e kishte mundësinë që në shkresën e saj më të fundit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ta llogariste edhe njëherë shumën e saktë që kjo drejtori i detyrohet kërkuarit në zbatim të urdhrin ekzekutiv të Gjykatës së Apelit Tiranë, ashtu si ka bërë për shumë kreditorë të tjerë në shkresën e datës 20.1.2010. Gjithashtu, Gjykata çmon se është e pajustificuar që DPT-ja nuk ka filluar të bëjë shlyerjen e kërkuarit, sipas parashikimeve të nenit 537 të KPC-së në përputhje me urdhrin e ekzekutimit të Gjykatës së Apelit, i cili ka më shumë se 2 vjet e 8 muaj që është marrë.

14. Përsa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuarit Artan Hajdini i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.313, datë 10.7.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatohet cenimi i së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.313, datë 10.7.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Petrit Plloçi, Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Admir Thanza.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 12.5.2011
Doli nga shtypi më 13.5.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 24 lekë